



Matrica e Komenteve Teknike

Draft Udhërrëfyesi për Tranzicion të Drejtë | Kontribut i **GREEN ENERGY KOSOVA**

Nr.	Tema	Çështja e identifikuar	Rekomandimi i GEK
1	Titulli, mandati dhe horizonti	Dokumenti i konsultimit e vendos tranzicionin deri në 2040, ndërsa drafti përdor “2033 e tutje” pa mbyllje, pika vendimmarrëse ose lidhje të qartë me 2050.	Udhërrëfyes Kombëtar për Tranzicion të Drejtë 2026–2050, i mbështetur nga një Plan Veprimi për periudhën 2026–2040, me kosto, afate dhe burime të qarta financimi.
2	Statusi juridik dhe përgjegjësia	Nuk sqarohet akti i miratimit, institucioni bartës, obligimi për raportim apo cikli formal i rishikimit.	Të vendoset bazë institucionale, pronar dokumenti, detyrime raportimi dhe mekanizëm rishikimi.
3	Metodologjia	Drafti nuk paraqet metodologjinë, vitin bazë, supozimet, kufizimet ose mënyrën e validimit të të dhënave.	Të publikohet Aneksi Kombëtar i të Dhënave Bazë dhe metodologjia e plotë.
4	Përputhshmëria ligjore	Referencat ndaj acquis, NECP-it, MRVA-së, NERP-it, IED-it dhe tregut janë deklarative.	Të përfshihet matrica: instrumenti, obligimi, statusi, boshllëku, afati, institucioni dhe masa e Udhërrëfyesit.
5	Skenarët	Nuk ka skenarë të krahasueshëm për energjinë, emetimet, punësimin, importet, koston dhe sigurinë.	Të modelohen së paku katër skenarë: i) politika aktuale, ii) siguria e furnizimit, iii) tranzicioni i përshpejtuar dhe iv) trajektorja 2050.
6	Siguria e furnizimit	Siguria trajtohet si parim, pa LOLE, EENS, rezervë, stres-teste, disponueshmëri të njëjse ose rrezik importi.	Të vendosen standarde dhe të publikohet vlerësim i përshtatshmërisë së sistemit.
7	Bilanci energjetik	Importet përmenden pranë prodhimit vendor, duke përzier prodhimin, tregtinë dhe kërkesën.	Të ndahen qartë prodhimi vendor, importet, eksportet, humbjet, kërkesa finale dhe piku.
8	Kapacitetet BRE	Drafti përdor disa caqe dhe shifra BRE pa përkufizime të njëjta ose vit reference të harmonizuar.	Të krijohet tabelë konsoliduese me kapacitet të instaluar, të lidhur, të licencuar, të kontraktuar dhe në ndërtim.
9	BESS dhe fleksibiliteti	BESS-i shprehet në MW pa MWh, kohëzgjatje, vendndodhje, shërbim sistematik, pronësi ose model operimi.	Të prezantohet portofol fleksibiliteti: MW/MWh, demand response, agregim, treg balancues, hidro dhe rezervë.
10	Rrjeti	Fokusi në transimision nuk mjafton për integrimin e prosumatorëve, pompave të nxehtësisë dhe BRE-ve në shpërndarje.	Të hartohet Plan i Integruar KOSTT-KEDS-ZRRE për rrjetin, hosting capacity, smart meters dhe curtailment.
11	Kosova B	Zgjatja/modernizimi përmendet pa analizë të krahasueshme të koston, emetimeve, rrezikut të aseteve të bllokuara dhe alternativave.	Të kryhet vlerësim i pavarur për operim bazë, fleksibil, rezervë dhe dalje të përshpejtuar.
12	Kosova A / rezervë strategjike	“Rezerva strategjike” nuk përkufizohet me njësi, MW, orë operimi, aktivizim, financim ose datë daljeje.	Të përcaktohet juridikisht, teknikisht, financiarisht dhe kohorisht, me Test Gatishmërie.
13	IED, NERP dhe	Përputhshmëria me ndotësit lokalë trajtohet si pjesë e tranzicionit pa	Të paraqiten trajektore të ndara për NOx, SO2, pluhur, CO2/CO2e,

	dekarbonizimi	ndarje të qartë nga dekarbonizimi.	metodë monitorimi dhe verifikim.
14	Minierat, hiri dhe tokat	Mungon inventari i detyrimeve, kostove, përgjegjësi dhe ripërdorimit të tokës.	Të hartohet Plan Kombëtar për Mbylljen e Minierave, Hirin, Tokën, Ujin dhe Rehabilitimin.
15	Shëndeti dhe mjedisi	Nuk ka indikatorë të ekspozimit të komuniteteve ndaj ajrit, ujit, tokës dhe ndikimeve shëndetësore.	Të shtohen indikatorë, bazë monitorimi dhe raportim publik i pavarur.
16	Territori	Obiliqi dhe Fushë Kosova përmenden pa plane territoriale të detajuara, projekt-pipeline ose financim të diferencuar.	Të përcaktohen Territore Prioritare dhe të hartohen Plane Territoriale të Tranzicionit të Drejtë.
17	Punëtorët	Numri total i punëtorëve nuk tregon moshë, profesion, pensionim, vendbanim, shëndet ose aftësi të transferueshme.	Të krijohet profil i plotë i punëtorëve të KEK-ut, kontraktorëve dhe zinxhirit lokal.
18	Kontraktorët	Puna indirekte, nënkontraktorët dhe furnitorët lokalë nuk janë pjesë e analizës.	Të bëhet hartë e ndikimit direkt, indirekt dhe të induktuar në punësim.
19	“Punë së pari”	Parimi nuk përcakton çfarë llogaritet si punë zëvendësuese ose standarde të cilësisë së punës.	Të përcaktohen kriteret për punë të denjë, afërsinë, pagën, sigurinë dhe qëndrueshmërinë.
20	Mbrojtja sociale	Nuk ka pensionim të mbështetur, mbrojtje të të ardhurave, ndërmjetësim punësimi, mekanizëm ankese ose kosto.	Të hartohen plane individuale dhe paketë e financuar e tranzicionit social.
21	Gjinia dhe rinia	Caqet e përgjithshme nuk shoqërohen me bazë fillestare, rol teknik, pengesa dhe masa konkrete.	Të përfshihet plan gjinor, bursa, praktikë, punësim teknik, siguri dhe prokurim i ndjeshëm ndaj gjinisë.
22	Varfëria energjetike	Mungon definicioni, regjistri, baza fillestare, instrumentet dhe cakjet e reduktimit.	Të krijohet Korniza Kombëtare për Varfërinë Energjetike me masa të synuara.
23	Ngrohja dhe ndërtesat	Ngrohja qendrore trajtohet kryesisht si projekt, pa integrim me renovim, pompa të nxehtësisë ose tarifat.	Të hartohet Plan Kombëtar për Tranzicionin e Ngrohjes dhe Ftohjes 2026-2050.
24	Efiçienca e energjisë	Caqet e kursimeve nuk shoqërohen me metodologji të vetme, investim, sektor, verifikim ose trajektore vjetore.	Të krijohet kornizë e vetme e kursimeve me metodë, kosto dhe verifikim.
25	Komunitetet e energjisë	Përmenden si mundësi pa rrugë rregullative, financiare ose projekte pilot territoriale.	Të miratohen aktet nënligjore dhe të zhvillohen pilotë projekte në Obiliq dhe Fushë Kosovë.
26	Financimi	Lista e partnerëve nuk tregon kosto të plotë, burime të konfirmuara, status, CAPEX/OPEX ose boshllëk financiar.	Të hartohet Plan Kombëtar i Investimeve dhe Financimit 2026-2050.
27	Kosto sociale	Punëtorët, pensionet, të ardhurat tranzitore, komunat dhe familjet e	Të krijohen linja të ndara buxhetore për mbrojtje sociale dhe territoriale.

		cenueshme nuk janë të kostuara.	
28	Rehabilitimi financiar	Nuk ndahet financim për miniera, hiri, tokë, ujë, monitorim dhe ripërdorim.	Të përcaktohen përgjegjësitë, rezervat financiare dhe parimi ndotësi-paguan.
29	Fondi për Tranzicion të Drejtë	Referencat ndaj fondit janë të paqarta; mungon dizajni ligjor dhe operacional.	Të dizajnohet Fondi: dritare për njerëz, territor, mjedis, energji të përballueshme dhe projekt-përgatitje.
30	Ndihma shtetërore	Investimet publike dhe masat për KEK-un nuk lidhen me vlerësim të konkurrencës, ndihmës shtetërore ose vlerë për para.	Të kërkohej kontroll i ndihmës shtetërore, analizë alternativash dhe transparencë e garancive publike.
31	Qeverisja	Koordinimi vetëm përmes Këshillit Kombëtar nuk mjafton për zbatim, financim, projekte dhe monitorim.	Të krijohen Komitet Ndërmintor, Njësi Zbatimi, Platformë Territoriale, strukturë KEK dhe Panel Teknik.
32	Pjesëmarrja	Komunitetet, sindikatat, gratë, të rinjtë dhe shoqëria civile nuk kanë role të formalizuara.	Të krijohet protokoll pjesëmarrjeje, anëtarësi, procesverbale, përgjigje publike dhe mekanizëm ankese.
33	Tabelat e zbatimit	Fazat nuk përmbajnë masë, pronar, kosto, afat, burim, KPI, varësi apo dëshmi.	Të përdoret format standard: masë, përgjegjës, afat, kosto, financim, output, KPI, rrezik dhe evidencë publike.
34	KPI-të	KPI-të janë të kufizuara; disa janë kontradiktore ose pa metodologji dhe ndarje territoriale.	Të krijohet kornizë e plotë KPI me bazë, cak vjetor, burim, pronar, metodë dhe verifikim.
35	KPI socialë	Mungojnë indikatorët për punëtorë, kontraktorë, cilësi pune, të ardhura familjare dhe përfitim lokal.	Të shtohen indikatorë të profilizimit, trajnimit, punësimit, pensionimit, mbrojtjes së të ardhurave dhe projekteve lokale.
36	KPI mjedisorë	Mungojnë indikatorë për miniera, hiri, tokë, ujë, ajër dhe ndikim shëndetësor.	Të shtohen NOx, SO2, pluhur, CO2e, hektarë rehabilitim, ujëra nëntokësore dhe rikthim toke.
37	Regjistri i rrezikut	Drafti identifikon disa rreziqe, por nuk përcakton për secilin rrezik nivelin e mundësisë dhe ndikimit, institucionin përgjegjës, treguesit paralajmërues, masat parandaluese, procedurën e reagimit ose burimet financiare rezervë..	Të krijohet një Plan i Menaxhimit të Rreziqeve, i cili për secilin rrezik përcakton: mundësinë e ndodhjes, ndikimin, institucionin përgjegjës, treguesit paralajmërues, masat për zbutje, hapat e reagimit, burimet rezervë dhe mënyrën e raportimit publik. Plani duhet të mbulojë së paku rreziqet nga çmimi i karbonit dhe CBAM-i, vonesat në rrjet, performanca dhe zëvendësimi i BESS-it, rritja e tarifave, thatësira dhe ndikimet klimatike, siguria kibernetike, vonesat në financim dhe konfliktet sociale.
38	Rishikimi	“Rishikim sipas nevojës” e bën adaptimin fakultativ/vullnetar ose opsional.	Të vendosen raporte vjetore, auditim teknik dyvjeçar dhe rishikime formale 2030, 2035, 2040, 2045.

39	VSM/VNM, baza mjedisore dhe ndikimet kumulative	Drafti nuk sqaron nëse Udhërrëfyesi i është nënshtruar Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), nuk paraqet bazë fillestare të verifikueshme për cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe ndikimet në shëndet, dhe nuk kërkon qartë që projektet individuale të kalojnë procedurat përkatëse të VNM/ESIA-së.	Para miratimit përfundimtar, të kryhet ose të publikohet VSM-ja e Udhërrëfyesit, me vlerësim të ndikimeve kumulative, rreziqeve klimatike dhe ujore, si dhe me bazë fillestare për ajrin, ujin, tokën dhe shëndetin publik. Për çdo projekt konkret të energjisë, minierave, rehabilitimit ose infrastrukturës të kërkohej VNM/ESIA sipas legjislacionit në fuqi, konsultim publik dhe monitorim i pavarur.
40	Referencat	Baza e evidencës nuk përfshin sistematikisht të dhëna nga KOSTT, KEDS, ERO, KEK, punësimi, mjedisi dhe fizibilitetet.	Të zgjerohet bibliografia dhe të identifikohet statusi i çdo burimi, viti dhe përgjegjësia për përditësim.
41	Transparenca	Nuk kërkohej publikimi i modeleve, të dhënave, financimit, kontratave, progresit dhe përgjigjeve ndaj konsultimit.	Të krijohet portal publik me dashboard, financim, projekte, indikatorë, konsultime dhe raporte.
42	Procesi pas konsultimit dhe dëgjimet publike	Drafti nuk përcakton hapat pas pranimit të komenteve me shkrim, afatin për publikimin e përgjigjeve të Ministrisë, publikimin e versionit të rishikuar ose organizimin e dëgjimeve publike me komunitetet dhe palët e prekura.	Ministria të publikojë një matricë zyrtare të përgjigjeve ndaj çdo komenti, draftin e rishikuar dhe evidencën që mbështet ndryshimet. Para miratimit përfundimtar, të organizohen dëgjime publike të dokumentuara në Prishtinë, Obiliq dhe Fushë Kosovë, me pjesëmarrjen e komunave, KEK-ut, sindikatave, punëtorëve, grave, të rinjve, komuniteteve, biznesit dhe shoqërisë civile.